



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 39

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 20 mars 2018

PËRMBAJTJA

Ligj nr. 12/2018
datë 5.3.2018

Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme.....

Faqe

2379



LIGJ
Nr. 12/2018

**PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE
PERIODIK TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHETIT, GARDËS SË
REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR
ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE
ANKESAT NË MINISTRINË
E BRENDSHME**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka si objekt përcaktimin e parimeve, kriterëve, procedurave dhe standardeve të vlerësimit kalimtar dhe periodik, si dhe të organizimit dhe funksionimit të organeve të vlerësimit për punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është vlerësimi kalimtar dhe periodik i punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme, për të siguruar institucione të forta e të besueshme, me profesionistë me integritet.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Anëtar”, “bashkëpunëtor” dhe “i favorizuar” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit të bërë në ligjin për të drejtën e informimit me dokumentet e ish-Shërbimit të Sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

2. “Ditë” janë ditë kalendarike, të cilat llogariten sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. “Dokument vlerësimi” është çdo dokument zyrtar i përgatitur nga punonjësi, që i nënshtrohet vlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe që provon aftësitë e tij profesionale.

4. “Institucione të vlerësimit kalimtar” janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Komisioni Qendror i Vlerësimit dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit.

5. “Kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim verbal apo elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi e qëllimshme, që nuk përputhet dhe/ose nuk ka lidhje me ushtrimin e detyrës nga punonjësi, pavarësisht nëse vendoset marrëdhënie biznesi apo ndonjë marrëdhënie tjetër.

6. “Marrëdhënie biznesi” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

7. “Niveli i besueshëm në vlerësimin e pasurisë” është konstatimi, në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë, se pasuritë e deklaruar nga punonjësi justifikohen nga burimet e të ardhurave.

8. “Niveli i besueshëm në kontrollin e figurës” është konstatimi, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, se punonjësi nuk ka pengesa për vazhdimin e ushtrimit të detyrës, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

9. “Niveli i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale” është konstatimi, në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive, se arsimi, trajnimet dhe përmbushja e detyrave nga ana e punonjësit është në përputhje me kërkesat specifike të pozicionit të punës dhe të gradës përkatëse.

10. “Partnerë ndërkombëtarë” janë organizatat ndërkombëtare dhe misionet e huaja që asistojnë Ministrinë e Brendshme, me të cilat organet e vlerësimit konsultohen gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të vlerësimit dhe vlerësimit kalimtar të punonjësve.

11. “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të bërë në legjislacionin në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.



12. “Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e vlerësimit apo me anëtarët e organeve të vlerësimit, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e vlerësimit apo anëtarin e organeve të vlerësimit për periudhën e vlerësimit.

13. “Person i përfshirë në krimin e organizuar” ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me punonjësën, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi gjatë periudhës së vlerësimit.

15. “Punonjës i Gardës së Republikës” është personi i emëruar në Gardën e Republikës, me gradë, në përputhje me ligjin për Gardën e Republikës së Shqipërisë.

16. “Punonjës i SHÇBA-së” është personi i emëruar në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nëpunësve civilë.

17. “Punonjës policie” është personi i emëruar në Policinë e Shtetit, me gradë policore, në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit.

18. “Subjekt vlerësimi” janë punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 15, 16 e 17, të këtij neni, si dhe ish-punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, pika 5, të këtij ligji.

19. “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e punonjësit dhe të personave të lidhur, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat.

20. “Grupë vlerësimi” është njësia e vlerësimit e organizuar në formën e organit kolegjal përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj punonjësve që do të vlerësohen sipas këtij ligji.

21. “Grupë e posaçme vlerësimi” është trupa e vlerësimit, që krijohet në Komisionin Qendror të Vlerësimit dhe në Komisionin Vendor të Vlerësimit, që vlerëson punonjësit e njësive/repartëve/strukturave, përbërja apo tipologjia e punës së të cilave, nuk mund të jenë publike.

22. “Trust” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit

të terrorizmit, si dhe nga legjislacioni ndër-kombëtar.

23. “Veprimtari kriminale” është kryerja me dashje e veprave penale, sipas parashikimeve në legjislacionin penal.

24. “Procesi i vlerësimit” përfshin si procesin kalimtar, ashtu edhe procesin periodik të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme.

Neni 4

Vlerësimi kalimtar

1. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve ka për objekt:

- a) vlerësimin e pasurisë;
- b) kontrollin e figurës;
- c) vlerësimin e aftësive profesionale.

2. Procesi i vlerësimit kalimtar bazohet në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

3. E drejta e informimit, e parashikuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, mund të kufizohet nga organi përkatës i vlerësimit. Organi përkatës i vlerësimit i kërkon mendim me shkrim Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Neni 5

Organet e vlerësimit kalimtar

1. Organet e vlerësimit kalimtar janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Komisioni Qendror i Vlerësimit dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit.

2. Organet e vlerësimit kalimtar, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, zbatojnë procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Organet e vlerësimit kalimtar organizohen në trupa vlerësimi, të cilat veprojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe janë përgjegjëse për verifikimin, vlerësimin, si dhe për marrjen e vendimeve ndaj punonjësve.

4. Trupa e vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë, të cilët caktohen me short nga komisioni përkatës i vlerësimit. Relatori i trupës së vlerësimit caktohet me short.



5. Anëtarët e trupave të vlerësimit pajisen me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet e trajtimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

6. Organet e vlerësimit kalimtar mbështeten gjatë veprimtarisë së tyre nga sekretariate teknike, sipas parashikimeve të këtij ligji.

7. Punonjësit, të cilët vlerësohen nga secila trupë vlerësimi, caktohen sipas një shorti. Procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit përcaktohen nga komisioni përkatës i vlerësimit.

Neni 6

Fushat e ushtrimit të veprimtarisë së organeve të vlerësimit kalimtar

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit vlerëson punonjësit në pozicionet ose me gradat e mëposhtme:

a) drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor e zëvendësdrejtor vendor dhe shef komisariati, në Policinë e Shtetit;

b) komandant e zëvendëskomandant, si dhe çdo oficer me gradë major, nënkolonel dhe kolonel në Gardën e Republikës;

c) drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, si dhe drejtor e shef sektori në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

2. Komisioni Qendror i Vlerësimit vlerëson:

a) punonjësit e policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në strukturat e veçanta, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, punonjësit e Akademisë së Sigurisë dhe të Institutit të Policisë Shkencore;

b) punonjësit e Gardës së Republikës me gradë nëntoger, toger, nënkapiten, kapiten;

c) punonjësit e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Komisioni Vendor i Vlerësimit vlerëson punonjësit e Policisë së Shtetit pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit dhe punonjësit e Gardës së Republikës, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij neni.

4. Punonjësit e njëjësive/reparteve/strukturave, përbërja e të cilave apo tipologjia e punës nuk mund të jenë publike, vlerësohen nga trupa të posaçme vlerësimi që krijohen në Komisionin

Qendror dhe Vendor të Vlerësimit, me propozimin e 3 titullarëve të institucioneve subjekt të këtij ligji.

5. Vlerësimit kalimtar i nënshtrohen, me kërkesë të tyre, edhe ish-punonjësit e këtyre institucioneve, të cilët plotësojnë këto kriterë:

a) nuk janë dënuar për kryerjen e një vepre penale;

b) nuk janë përjashtuar ose kur masa disiplinore e përjashtimit, e marrë ndaj tyre, është shfuqizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Kërkesa dhe formularët e deklarimit dorëzohen nga ish-punonjësi pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit përkatës, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.

KREU II

PËRBËRJA DHE ORGANIZIMI I ORGANEVE TË VLERËSIMIT KALIMTAR

Seksioni I

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Bordi i Përzgjedhjes

Neni 7

Bordi i Përzgjedhjes

1. Për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të sekretariatit teknik pranë këtij Komisioni, ngrihet Bordi i Përzgjedhjes.

2. Bordi i Përzgjedhjes përbëhet nga 5 anëtarë, përfaqësues të:

a) Ministrisë së Brendshme, i cili drejton bordin, Kryetar;

b) Avokatit të Popullit, anëtar;

c) Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, anëtar;

ç) Shërbimit Informativ Shtetëror, anëtar;

d) Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, anëtar.

3. Anëtarët e Bordit të Përzgjedhjes caktohen nga titullarët e institucioneve përkatëse, nga radhët e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues të këtyre institucioneve.

4. Bordi i Përzgjedhjes ushtron veprimtarinë e tij në konsultim me partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Brendshme.



Neni 8

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Përzgjedhjes

Anëtar i Bordit Përzgjedhës zgjidhet shtetasi shqiptar, i cili plotëson këto kriteret:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare;

b) ka eksperiencë pune, jo më pak se 5 vjet në profesion;

c) nuk ka ushtruar funksione politike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 3 viteve të fundit;

ç) ndaj tij nuk është nisur një hetim penal dhe ai nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtje penale me dashje;

d) nuk ka qenë subjekt i ndalimeve të parashikuara në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

dh) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila nuk është parashkruar, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, në momentin e aplikimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Neni 9

Përbërja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit përbëhet nga 15 anëtarë.

2. 5 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit caktohen nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, të përzgjedhur ndërmjet punonjësve të këtij institucioni, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Ky organ cakton, gjithashtu, edhe 2 anëtarë zëvendësues, të cilët zëvendësojnë anëtarët që mungojnë.

3. 10 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përzgjidhen nga Bordi i Përzgjedhjes.

4. 5 anëtarë të Komisionit, sipas pikës 3, të këtij neni, përzgjidhen nga 10 pedagogë të Universitetit të Tiranës, me propozimin e rektorit të këtij

institucioni. Për këtë qëllim, dekanët e fakulteteve të drejtësisë, ekonomisë dhe shkencave sociale i propozojnë rektorit nga 5 pedagogë secili.

5. 5 anëtarët e tjerë të komisionit përzgjidhen me konkurrim të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Bordi Përzgjedhës përzgjedh, gjithashtu, nga kandidaturat e paraqitura apo aplikantët, 4 anëtarë zëvendësues, të cilët ushtrojnë detyrën në rast mungesash të zgjatura të anëtarëve të përzgjedhur.

7. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit organizohet në 5 trupa vlerësimi, me 3 anëtarë secila.

Neni 10

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Anëtar i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit zgjidhet shtetasi shqiptar, i cili plotëson këto kriteret:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare;

b) ka eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet në profesion;

c) nuk ka ushtruar funksione politike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 3 viteve të fundit;

ç) ndaj tij nuk është nisur një hetim penal dhe ai nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;

d) nuk ka qenë subjekt i ndalimeve të parashikuara në ligjin për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;

dh) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila nuk është parashkruar, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, në momentin e aplikimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit “Për të drejtën e informimit me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

ë) është nën moshën 65 vjeç.

2. Anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, të cilët caktohen nga ILDKPKI-ja, krahas kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, me përjashtim të shkronjës “b”, duhet të jenë në pozicionin “Inspektor”.



3. 6 nga kandidatët për anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, të cilët propozohen nga Rektori i Universitetit të Tiranës, krahas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të jenë pedagogë nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Ekonomisë.

Neni 11

Paraqitja dhe shqyrtimi i aplikimeve për pozicionet e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Brenda 10 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Bordi i Përzgjedhjes publikon thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit për pozicionet e të gjithë anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

2. Afati për paraqitjen e propozimeve, të aplikimeve dhe dokumentacionit shoqërues është 15 ditë. Me përfundimin e këtij afati publikohet, menjëherë, lista e pjesëmarrësve në konkurrim.

3. Bashkë me propozimet dhe aplikimin dorëzohen edhe këto dokumente:

a) jetëshkrimin profesional, që përmban detajet e arsimimit, të punësimit dhe eksperiencave të tjera studimore, profesionale dhe personale, të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) kopje të dokumentit të identitetit;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

4. Brenda 7 ditëve, nga publikimi i listës së kandidatëve, Bordi i Përzgjedhjes konsultohet me partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Brendshme, përzgjedh anëtarët dhe publikon listën e fituesve.

Neni 12

Sekretariati teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit mbështetet nga një sekretariat teknik, i përbërë nga 15 punonjës, të përzgjedhur me procedurë të hapur konkurrimi nga Bordi i Përzgjedhjes.

2. Anëtar i sekretariatit teknik zgjidhet shtetasi shqiptar, i cili plotëson kriteret si më poshtë:

a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, ekonomi, financë, matematikë ose shkenca sociale ose të

barasvlershme me to, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

b) ka eksperiencë pune jo më pak 5 vjet;

c) ndaj tij nuk është nisur një hetim penal dhe ai nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;

ç) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila nuk është parashkruar, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, në momentin e aplikimit.

3. Përzgjedhja e anëtarëve të sekretariatit teknik bëhet nga Bordi i Përzgjedhjes, me procedurë të hapur e transparente, në të njëjtën mënyrë me atë të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

4. Organizimi dhe funksionimi i sekretariatit teknik përcaktohen me vendim të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Neni 13

Ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji, dhe me përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror të Vlerësimit dhe sekretariatit teknik përkatës.

Seksioni II

Komisioni Qendror i Vlerësimit

Neni 14

Komisioni Qendror i Vlerësimit

1. Komisioni Qendror i Vlerësimit përbëhet nga 45 anëtarë.

2. 15 anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit bëhen automatikisht anëtarë të Komisionit Qendror të Vlerësimit, pas përfundimit të përzgjedhjes së anëtarëve të tjerë.

3. 30 anëtarët e tjerë përzgjidhen nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, me procedurë të hapur konkurrimi, nga radhët e punonjësve të institucioneve që i nënshtrohen këtij vlerësimi, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3, të nenit 16, të këtij ligji.

4. Nga 30 anëtarët, që përzgjidhen sipas pikës 3, të këtij neni, 20 anëtarë zgjidhen nga Policia e



Shtetit, 6 nga Garda e Republikës dhe 4 nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit në fazën e parë.

5. Komisioni Qendror i Vlerësimit organizohet me 15 trupa vlerësimi, me 3 anëtarë secila.

Neni 15

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Qendror të Vlerësimit

Kandidatët për anëtarë të Komisionit Qendror të Vlerësimit, të cilët përzgjidhen nga punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

- a) të kenë kaluar me sukses vlerësimin e kryer nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit;
- b) të kenë përfunduar arsimin e lartë;
- c) të kenë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe/ose Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Neni 16

Paraqitja dhe shqyrtimi i aplikimeve për pozicionet e anëtarëve të Komisionit Qendror të Vlerësimit

1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, me përfundimin e procesit të vlerësimit në fazën e parë, shpall menjëherë hapjen e procedurës për pozicionet e anëtarëve të tjerë të Komisionit Qendror të Vlerësimit.

2. Afati për paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues është 15 ditë. Me përfundimin e këtij afati publikohet menjëherë lista e pjesëmarrësve në konkurrim.

3. Në rast pamjaftueshmërie aplikimesh, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit përzgjedh me short, si anëtarë të Komisionit Qendror të Vlerësimit, punonjës që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji, të cilët shprehin pëlqimin e tyre paraprak, për përfshirjen në short.

4. Kërkesa e kandidatit regjistrohet dhe ai pajiset me një dokument, që vërteton numrin e aplikimit, datën dhe listën e dokumenteve të paraqitura.

5. Së bashku me kërkesën e motivuar, kandidati dorëzon kopje të dokumenteve si më poshtë:

a) jetëshkrimit profesional, që përmban detajet e arsimit, të punësimit dhe eksperiencave të tjera studimore, profesionale e personale, të dhënat e kontaktit, të postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) dokumentit të identitetit;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

6. Brenda 7 ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit konsultohet me partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Brendshme, përzgjedh anëtarët dhe publikon listën e fituesve.

Neni 17

Sekretariati teknik i Komisionit Qendror të Vlerësimit

1. Komisioni Qendror i Vlerësimi mbështetet nga një sekretariat teknik, i përbërë nga 45 punonjës.

2. 15 anëtarët e sekretariatit teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit janë, automatikisht, edhe anëtarë të sekretariatit teknik pranë Komisionit Qendror të Vlerësimit.

3. 30 anëtarët e tjerë përzgjidhen nga punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, sipas këtyre kriterëve:

- a) të kenë kaluar me sukses procesin e vlerësimit nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit;
- b) të kenë përfunduar arsimin e lartë;
- c) të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune.

4. Përzgjedhja e anëtarëve të sekretariatit teknik të Komisionit Qendror të Vlerësimit bëhet nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, sipas së njëjtës procedurë të përzgjedhjes së anëtarëve të sekretariatit teknik pranë këtij komisioni.

5. Organizimi dhe funksionimi i sekretariatit teknik përcaktohet me vendim të Komisionit Qendror të Vlerësimit.

Neni 18

Ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit Qendror të Vlerësimit

Komisioni Qendror i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e vlerësimit të kategorisë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji, dhe me përzgjedhjen e anëtarëve të



Komisionit Vendor të Vlerësimit e të sekretariatit teknik përkatës.

Seksioni III

Komisioni Vendor i Vlerësimit

Neni 19

Komisioni Vendor i Vlerësimit

1. Komisioni Vendor i Vlerësimit përbëhet nga 135 anëtarë, 90 prej të cilëve përzgjidhen nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nga Komisioni Qendror i Vlerësimit, me procedurë të hapur konkurrimi.

2. Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, 45 anëtarët e Komisionit Qendror të Vlerësimit bëhen anëtarë të Komisionit Vendor të Vlerësimit.

3. Komisioni Vendor i Vlerësimit organizohet në 45 trupa vlerësimi, me 3 anëtarë secila.

4. Komisioni Qendror i Vlerësimit përcakton përbërjen e trupave dhe kompetencat lëndore e territoriale të secilës prej tyre.

Neni 20

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Vendor të Vlerësimit

Anëtar i Komisionit Vendor të Vlerësimit përzgjidhet punonjësi, i cili plotëson kriteret si më poshtë:

- a) ka kaluar me sukses procesin e vlerësimit nga Komisioni Qendror i Vlerësimit;
- b) ka përfunduar arsimin e lartë;
- c) ka jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe/ose Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Neni 21

Paraqitja dhe shqyrtimi i aplikimeve për pozicionet e anëtarëve të Komisionit Vendor të Vlerësimit

1. Komisioni Qendror i Vlerësimit shpall hapjen e procedurës për pozicionet e anëtarëve të Komisionit Vendor të Vlerësimit.

2. Afati për paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues është 15 ditë. Me përfundimin e këtij afati publikohet, menjëherë, lista e pjesëmarrësve në konkurrim.

3. Në rast pamjaftueshmërie aplikimesh, Komisioni Qendror i Vlerësimit përzgjedh me short, si anëtarë të Komisionit Vendor të

Vlerësimit, punonjës që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, të cilët shprehin pëlqimin e tyre paraprak, për përfshirjen e tyre në short.

4. Kërkesa e kandidatit regjistrohet dhe kandidati pajiset me një dokument, që vërteton numrin e aplikimit, datën dhe listën e dokumenteve të paraqitura.

5. Së bashku me kërkesën e motivuar, kandidati dorëzon kopje të dokumenteve si më poshtë:

a) jetëshkrimi profesional, që përmban detajet e arsimit, të punësimit dhe eksperiencave të tjera studimore, profesionale e personale, të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) dokumentit të identitetit;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

6. Brenda 7 ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve, Komisioni Qendror i Vlerësimit konsultohet me partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Brendshme, përzgjedh anëtarët dhe publikon listën e fituesve.

Neni 22

Sekretariati teknik i komisioneve vendore të vlerësimit

1. Komisioni Vendor i Vlerësimit mbështetet nga një sekretariat teknik, i përbërë nga 135 punonjës.

2. 45 anëtarët e sekretariatit teknik pranë Komisionit Qendror të Vlerësimit janë, automatikisht, edhe anëtarë të sekretariatit teknik pranë Komisionit Vendor të Vlerësimit.

3. 90 anëtarët e tjerë të sekretariatit teknik përzgjidhen nga punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, sipas këtyre kriterëve:

- a) të kenë kaluar me sukses procesin e vlerësimit nga Komisioni Qendror i Vlerësimit;
- b) të kenë përfunduar arsimin e lartë;
- c) të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune.

4. Përzgjedhja e anëtarëve të sekretariatit teknik të Komisionit Vendor të Vlerësimit bëhet nga Komisioni Qendror i Vlerësimit, sipas së njëjtës procedurë të përzgjedhjes së anëtarëve sekretariatit teknik pranë këtij komisioni.



5. Organizimi dhe funksionimi i sekretariatit teknik përcaktohen me vendim të Komisionit Vendor të Vlerësimit.

Neni 23

Ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit Vendor të Vlerësimit

Komisioni Vendor i Vlerësimit ushtron veprimtarinë deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji, por në çdo rast jo më vonë se afati i parashikuar për përfundimin në tërësi të procesit të vlerësimit kalimtar.

Seksioni IV

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të komisioneve dhe sekretariateve teknike

Neni 24

Kryetari i komisionit

1. Komisionet e çdo niveli drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë i caktuar prej tij.

2. Kryetari i komisionit zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

3. Mbledhja për zgjedhjen e kryetarit drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë. Në rast se ka më shumë se një kandidat dhe gjatë votimit asnjëri prej tyre nuk merr shumicën e nevojshme të votave, bëhet një votim i ri dhe, pas këtij, vijohet me votimin ndërmjet 2 ose më shumë kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në rast se edhe pas votimit të fundit rezultati është i barabartë, zgjedhja e kryetarit bëhet me short ndërmjet kandidatëve.

4. Kryetari i komisionit ka këto kompetenca:

a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjen e anëtarëve;

b) përfaqëson komisionin në marrëdhënie me të tretët;

c) bashkërendon punën në komision;

ç) nënshkruan të gjitha aktet e komisionit, me përjashtim të vendimeve për rezultatin e vlerësimit, të cilët nënshkruhen nga trupat e vlerësimit;

d) kryen detyra të tjera, të cilat, sipas këtij ligji, nuk u ngarkohen anëtarëve apo trupave të vlerësimit.

Neni 25

Kompetencat e anëtarëve të trupave të vlerësimit

1. Anëtarët e trupave të vlerësimit kanë këto kompetenca:

a) ndërmarrin të gjitha iniciativat dhe kryejnë të gjitha procedurat për të garantuar provat, të dhënat dhe informacionet e nevojshme për procesin e vlerësimit;

b) marrin të gjitha masat dhe hartojnë dokumentacionin e nevojshëm deri në përfundimin e çështjes;

c) kërkojnë informacion shtesë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) thërrasin individët apo persona të tjerë të informuar mbi faktet në seancat dëgjimore;

d) caktojnë detyra për anëtarët e sekretariatit teknik, në funksion të verifikimit të çështjeve;

dh) propozojnë dhe marrin vendimin e arsyetuar;

e) bashkërendojnë punën dhe marrin masa për të garantuar zbardhjen e vendimeve brenda 15 ditëve nga marrja e tyre.

2. Në raste të veçanta, kur kërkohet ekspertizë juridike e financiare, trupa e vlerësimit konsultohet me specialistë të fushave përkatëse të Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të tjera publike ose kontraktin ekspertë të pavarur, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Relatori i trupës së vlerësimit ka këto detyra:

a) përgatit dosjen që diskutohet nga trupa e vlerësimit, me mbështetjen e sekretariatit teknik;

b) ndërmerr të gjitha veprimet për të garantuar provat dhe informacionet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;

c) merr të gjitha masat për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm deri në përfundimin e çështjes.

Neni 26

Detyrat e anëtarëve të sekretariateve teknike

Detyrat e anëtarëve të sekretariateve teknike të komisioneve të vlerësimit janë:

a) studimi dhe analizimi i dosjes dhe mbështetja e anëtarëve të trupës së vlerësimit për përgatitjen e relacionit për pasurinë, kontrollin e figurës e të aftësive profesionale të punonjësve që i nënshtrohen vlerësimit;



b) mbështetja e anëtarëve të trupës së vlerësimit në përgatitjen e dosjeve që diskutohen;

c) kryerja e detyrave të tjera, të caktuara nga komisioni përkatës.

Neni 27

Përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të komisioneve të vlerësimit

1. Kusht për marrjen e detyrës së anëtarëve të komisioneve të vlerësimit është nënshkrimi i një deklarate, ku deklarohen mungesën e lidhjeve familjare dhe mosmarrëveshjeve gjyqësore apo administrative ndërmjet tyre dhe punonjësve, të cilët i nënshtrohen procesit të vlerësimit.

2. Anëtari i komisionit të vlerësimit shkarkohet në rastet e:

a) mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, kur ka dyshime të arsyeshme për ekzistencën e rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe nëse anëtari është në dijeni të rrethanave të tilla;

b) sjelljes, akteve dhe veprimeve të tjera të anëtarit, që krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në vlerësim;

c) mosnjohimit të kryetarit ose të organeve kompetente, sipas ligjit për ndërhyrjet apo ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe/apo punonjësve që i nënshtrohen vlerësimit;

ç) ndërhyrjeve ose çdo lloj ndikimi tjetër të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës së një anëtarit tjetër;

d) mospërbushjes së pajustifikuar dhe në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur të funksionit të tij;

dh) paraqitjes së kërkesës për heqje dorë dhe kryerjes së atyre veprimeve që nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj ose që bëhen në mënyrë të qëllimshme, për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët, apo kur synojnë të shmangin anëtarin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga anëtarë të tjerë, apo kur dorëheqja jepet e vonuar, megjithëse ka qenë në dijeni të faktit për të cilin jep dorëheqje;

e) shkeljes së përsëritur ose të rëndë të rregullave të solemnitetit dhe rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, si dhe

me anëtarët e sekretariatit teknik të organeve të vlerësimit;

ë) vonesës dhe zvarritjes së përsëritur e të pajustifikuar të veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit;

f) bërjes publike të mendimeve që ka dhënë vetë ose anëtarët e tjerë gjatë procesit për të cilin nuk është marrë ndonjë vendim nga trupa e vlerësimit;

g) shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi gjatë procesit të vlerësimit ose kur ky ka përfunduar, duke përfshirë publikimin dhe shpërndarjen, edhe për shkak të neglizhencës, të akteve ose informacioneve konfidenciale ose të akteve procedurale, të cilat rrjedhin nga çështjet që janë në proces hetimi ose vlerësimi;

gj) bërjes së deklaratave publike dhe në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij;

h) parashtrimit të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra;

i) përdorimit të mandatit të anëtarit për të realizuar përfitime të pajustifikuara vetjake ose për të tjerët;

j) shoqërimit me persona që janë në ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal apo me persona të dënuar penalisht, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose personave, të cilët janë të afërm me punonjësit që i nënshtrohen vlerësimit në lidhje gjaku apo me ligj, si dhe marrëdhëniet e biznesit të papërshtatshme me këta persona;

k) përfitimit të padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit;

l) sjelljes së papërshtatshme në përbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore e funksionarët e tyre, si dhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme;

ll) tjera, të parashikuara nga ky ligj.

Neni 28

Procedurat për shkarkimin e anëtarëve të komisioneve të vlerësimit

1. Në rast se ka të dhëna të mjaftueshme, nga burime të besueshme, se anëtari apo kryetari i



komisionit të vlerësimit ka kryer një shkelje disiplinore, ndaj tij fillon hetimi disiplinor nga një komision disiplinor.

2. Hetimi disiplinor mund të fillojë me kërkesë të çdo anëtari të komisionit të vlerësimit dhe çdo anëtari të sekretariatit teknik pranë komisionit të vlerësimit.

3. Komisioni disiplinor përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët zgjidhen me short, rast pas rasti, pa pjesëmarrjen e anëtarit për të cilin është kërkuar fillimi i hetimit disiplinor. Rregullat dhe procedura për zhvillimin e procedimit disiplinor përcaktohen nga komisioni përkatës.

4. Anëtari i komisionit të vlerësimit, i cili i nënshtrohet procedimit disiplinor, ka të drejtë të informohet, të mbrohet dhe të dëgjohet gjatë procedimit disiplinor.

5. Në përfundim të procedurës, komisioni disiplinor vendos për shkarkimin ose jo të anëtarit, ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor.

6. Për zëvendësimin e anëtarit të shkarkuar caktohen në detyrë anëtarët zëvendësues dhe, në rast pamjaftueshmërie, zbatohen procedurat e parashikuara për përzgjedhjen e tij.

7. Shkarkimi nga detyra i anëtarit të komisionit të vlerësimit nuk ndikon në raportet e tjera të punësimit të anëtarit, por i njoftohet menjëherë institucionit përkatës.

Neni 29

Trajtimi financiar

1. Anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sekretariateve teknike punojnë me kohë të plotë dhe gëzojnë trajtim financiar të veçantë.

2. Trajtimi financiar për Bordin e Përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, për anëtarët e komisioneve dhe anëtarët e sekretariateve teknike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në përfundim të procesit të vlerësimit, anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kthehen në vendet e tyre të punës ose, me pëlqimin e tyre, në vende të barasvlershme.

4. Në përfundim të procesit të vlerësimit, anëtarët e Komisionit Qendror dhe Vendor të Vlerësimit, të përzgjedhur nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, rikthehen në pozicionet e tyre të mëparshme.

Neni 30

Mbështetja logjistike e komisioneve të vlerësimit

Ministria e Brendshme siguron mjediset e punës së organeve të vlerësimit dhe i mbështet ato me logjistikën e nevojshme për të ushtruar përgjegjësitë që u ngarkon ky ligj.

KREU III

VLERËSIMI I PASURISË

Neni 31

Objekti i vlerësimit të pasurisë

Objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të.

Neni 32

Fillimi i procedurës për deklarimin e pasurisë

1. Punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij ligji. Ky deklarim fillon ditën e parë të marrëdhënies së punës.

2. Punonjësi plotëson deklaratën e pasurisë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1, të këtij neni, brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe e dorëzon në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon.

3. Nëse punonjësi nuk dorëzon deklaratën e pasurisë, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij neni, ai largohet nga detyra.

4. Njësia e burimeve njerëzore e vendos deklaratën e pasurisë në dosjen përkatëse, të çelur për punonjësin, dhe e dërgon në komisionin përkatës të vlerësimit.

5. Punonjësi mund të paraqesë të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Paraqitja e plotë e dokumenteve, që vërtetojnë ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave, vlerësohet bashkë me rrethanat e tjera për marrjen e vendimit të vlerësimit.



Neni 33

Deklarimi i pasurisë

1. Punonjësi, i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron:

a) të ardhurat personale dhe ato të personave të lidhur, sipas certifikatës familjare, nga çfarëdo lloj aktiviteti, për të gjithë periudhën e përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të këtij ligji;

b) shpenzimet e vitit të fundit për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të tij apo të personave të lidhur;

c) udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë shtetit gjatë tre viteve të fundit, duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe, me përafërsi, shpenzimet e përballuara;

ç) arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, në momentin e deklaramit, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve për të gjithë periudhën e përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të këtij ligji;

d) sendet e paluajtshme të fituara, tjetërsuara, poseduara apo përdorura për të gjithë periudhën e përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të këtij ligji;

dh) sendet e luajtshme apo sendet me vlerë mbi 300 000 lekë, përfshirë, por pa u kufizuar, mjetet motorike të fituara, tjetërsuara, poseduara apo përdorura për të gjithë periudhën e përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të këtij ligji;

e) investimet apo mjete të tjera financiare që prodhojnë të ardhura, përfshirë, por pa u kufizuar, aksionet apo kuotat e shoqërive tregtare, titujt e kredisë, licenca, patentat apo të drejta të tjera;

ë) llogaritë bankare, brenda dhe jashtë vendit, duke specifikuar numrat, vendndodhjen, datën e krijimit dhe gjendjen aktuale;

f) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë;

g) të gjitha marrëdhëniet juridike, që kanë vlerë ekonomiko-pasurore;

gj) burimet e krijimit të këtyre pasurive.

2. Të gjitha subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare), të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklaratën e pasurisë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë

gjendje në *Cash* jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *Cash* mbi vlerën 1,5 milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së pasurisë pranë njësive të burimeve njerëzore.

Neni 34

Procedura e vlerësimit të pasurisë

1. Trupa e vlerësimit, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon një procedurë kontrolli, në përputhje me këtë ligj, ligjin për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë, ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Verifikimet për punonjësin kryhen në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë, të cilët detyrohen të japin të dhëna në lidhje me deklaramet apo mosdeklaramet e këtyre punonjësve.

3. ILDKPKI-ja vë në dispozicion të gjitha informacionet që disponon, si rezultat i deklaramit të punonjësve, të cilët kanë pasur detyrimin për deklaramin e pasurive sipas ligjit përkatës.

4. Trupa e vlerësimit, për vlerësimin e pasurive të deklaruara nga punonjësi, mund të kryejë verifikime në terren.

5. Trupa e vlerësimit mund të kërkojë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ministrisë së Drejtësisë, dokumentet për pasuritë në pronësi të punonjësit dhe personave të lidhur me të, të dhënat financiare për çdo transaksion financiar, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

6. Në përfundim të procedurës së kontrollit të pasurisë, trupa e vlerësimit, bazuar në të dhënat që ka mbledhur, përgatit një raport të hollësishëm e të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se:

a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, kur rezulton



se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të;

c) është kryer fshehje e pasurisë;

ç) është kryer deklarim i rremë;

d) punonjësi gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

KREU IV KONTROLLI I FIGURËS

Neni 35

Objekti i kontrollit të figurës

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramëve të punonjësit dhe i të dhënave të tjera, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklaramëve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale.

Neni 36

Fillimi i procedurës për kontrollin e figurës

1. Punonjësi plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij ligji, dhe e dorëzon atë brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e tij, në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon.

2. Njësia e burimeve njerëzore e vendos deklaratën për kontrollin e figurës në dosjen përkatëse, të çelur për punonjësin, dhe e dërgon në komisionin përkatës të vlerësimit.

3. Verifikimi i figurës së punonjësit realizohet nëpërmjet:

a) kontrollit të deklaramëve dhe marrjes së informacionit nga Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, për të dhënat që ky institucion disponon;

b) kontrollit të deklaramëve dhe marrjes së informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

c) kontrollit të deklaramëve dhe marrjes së informacionit nga Shërbimi Informativ i Shtetit, për të dhënat që ky institucion disponon;

ç) kontrollit të informacioneve dhe materialeve të tjera, që disponohen në strukturat e analizës së informacionit të Policisë së Shtetit, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si dhe në agjencitë e tjera informative dhe ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë;

d) kontrollit të bazave të të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë;

dh) bashkëpunimit me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;

e) bashkëpunimit me prokurorinë dhe gjykatat, në rast se punonjësi ka qenë apo është subjekt i procedimeve penale;

ë) verifikimit të informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur.

Neni 37

Bashkëpunimi për kontrollin e figurës

1. Për kontrollin e figurës së punonjësit, organet e vlerësimit i drejtohen Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimit Informativ të Shtetit, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, për informacione ose të dhëna të tjera që mund të kenë këto institucione, apo shërbimeve të tjera informative, brenda vendit.

2. Organet e vlerësimit u drejtohen për informacion edhe strukturave apo njësite të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilat mund të kenë informacion.

3. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar apo Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me kërkesën e organeve të vlerësimit, komunikon me shtetet e huaja për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në veprimtari kriminale ose për personat e dyshuar si të përfshirë në veprimtarinë kriminale, për qëllim të këtij ligji.

4. Institucionet e tjera publike, që mbledhin dhe përpunojnë informacion, vënë në dispozicion të dhënat për punonjësit, personat e lidhur apo personat e tjerë, sipas kërkesave të organeve të vlerësimit.

Neni 38

Vlerësimi i rrethanave për kontrollin e figurës

1. Për kontrollin e figurës, trupat e vlerësimit mbajnë në konsideratë si më poshtë:

a) verifikimin e saktë të identitetit në të shkuarën dhe të tashmen për çdo punonjës, që i nënshtrohet



kontrollit, dhe arsyen e ndryshimeve të emrit, mbiemrit apo gjenealiteteve të tjera;

b) të dhënat për vendbanimin aktual e të mëparshëm, brenda dhe jashtë vendit;

c) rastet e ndryshimeve ose të marrjes së shtetësive të tjera;

ç) ndalimin për hyrje në vendet e Bashkimit Europian ose të NATO-s;

d) kërkesën për azil në ndonjë shtet;

dh) verifikimin e procedimeve penale dhe administrative ndaj punonjësit, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;

e) dëbimin nga shtete të tjera, për shkelje të rregullave të hyrjes apo qëndrimit;

ë) testimin për përdorim lëndësh narkotike;

f) varësinë nga alkooli apo nga lojërat e fatit;

g) verifikimin nëse ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit për të drejtën e informimit me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

2. Punonjësi i nënshtrohet një testi psikologjik të personalitetit, si dhe, me vendim të trupës së vlerësimit përkatëse dhe me pëlqimin e tij, testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale. Refuzimi i kryerjes së testeve vlerësohet së bashku me rrethanat e tjera.

Neni 39

Standardet e kontrollit e figurës

1. Kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova, informacione të klasifikuara dhe informacione të tjera të disponueshme.

2. Kontrolli i figurës zhvillohet në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, të cilat mund të favorizojnë ose jo punonjësin.

3. Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave, të dhënave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, përfshirë rrethanat rënduese apo ato lehtësuese.

4. Rrethanat, që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë:

a) punonjësi ose personi i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri, me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

b) punonjësi ose personi i lidhur me të ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

c) punonjësi ose personi i lidhur me të merr pjesë apo është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe kur anëtarësia e personit në krimin e organizuar është e njohur, e dyshuar, e publikuar ose e dokumentuar.

5. Nuk konsiderohen kontakte të papërshtatshme të punonjësit ato që rezultojnë në përmbushje të detyrave funksionale apo në kuadër të veprimeve policore apo operacionale.

Neni 40

Rrethana rënduese në kontrollin e figurës

Rrethanat rënduese, që merren parasysh në rastet kur formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, janë kur:

a) punonjësi nuk pasqyron në formular kontakte, që janë konstatuar nga prova, informacione të besueshme apo të dhëna të tjera;

b) ka të dhëna të tjera për një përfitim, veprim ose pasoje nga kontakti, që krijojnë bindjen e arsyeshme dhe të bazuar se informacioni i marrë është shpjegimi i vetëm i mundshëm.

Neni 41

Rrethanat lehtësuese në kontrollin e figurës

1. Rrethanat lehtësuese, që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë:

a) kur punonjësi, në mënyrë të besueshme, parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar;

b) kur kontaktet kushtëzohen nga marrëdhënia familjare e punonjësit dhe këto kontakte familjare janë të rralla;

c) kur punonjësi është bashkëpunues, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet dhe është distancuar prej tyre;

ç) kur punonjësi ka qenë në dijeni që personi është i përfshirë në krimin e organizuar, por nuk ka



qenë në dijeni të faktit se ai do të ishte i pranishëm në një takim ose është mashtruar për një takim të tillë;

d) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila parashtrohet në mënyrë të besueshme nga punonjësi.

2. Rrethanat lehtësuese, që merren parasysh në rastet kur formulari i deklarimit nuk është përfunduar plotësisht dhe me besueshmëri, janë:

a) punonjësi rendit në listë një kontakt, por data ose vendndodhja nuk është e saktë;

b) punonjësi nuk rendit në listë një kontakt, por ka qenë i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet e tjera;

c) kontakti ka ndodhur në një vend me shumë njerëz dhe nuk mund të mbahej mend ose mund të mendohej i parëndësishëm. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontaktit ose me faktorë të tjerë;

ç) punonjësi nuk rendit në listë një kontakt që ka të bëjë me një anëtar të familjes, kur rrethanat e atij kontakti nuk mund të mbaheshin mend ose nuk ishin të rëndësishme;

d) punonjësi parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar;

dh) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila parashtrohet në mënyrë të besueshme nga punonjësi.

Neni 42

Procedura për kontrollin e figurës

1. Për kontrollin e figurës, trupa e vlerësimit verifikon nëse informacioni i deklaruar është i saktë dhe i besueshëm, si dhe nëse punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

2. Në përfundimin e procesit të kontrollit të figurës, trupa e vlerësimit përgatit raportin e arsyetuar, në të cilin përcaktohet nëse:

a) punonjësi ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;

b) ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale;

c) punonjësi është i përshtatshëm ose jo për vazhdimin e detyrës.

3. Ky raport përmban informacion për kontaktet e punonjësit dhe nuk bëhet publik, nëse ai rrezikon sigurinë e burimit të informacionit ose për shkak të rrethanave të tjera objektive.

KREU V

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Neni 43

Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale

Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimit të rregullave të etikës, si dhe i përmbushjes së detyrave nga punonjësi, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Neni 44

Fillimi i procedurës për vlerësimin e aftësive profesionale

1. Punonjësi plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij ligji, dhe, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e tij, e dërgon pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku punon.

2. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 7 vjet.

3. Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional, ka më pak se 7 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës.

Neni 45

Burimet për vlerësimin e aftësive profesionale

1. Aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar në legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës së subjektit të vlerësimit dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.



2. Objekt i vlerësimit profesional janë dokumentet e përgatitura nga vetë punonjësi, të përcaktuara sipas këtyre niveleve:

a) Për nivelin menaxherial:

i) analiza, përgjithësime dhe studime të kryera;

ii) dokumente strategjike, plane veprimi dhe plane vendosjeje;

iii) pjesëmarrje dhe kontribut konkret në grupe pune për hartimin e dokumenteve ose projektakteve ligjore e nënligjore;

iv) informacione dhe raportime;

v) kontrolle, inspektime dhe rekomandime për përmirësimin e punës;

vi) akte të bashkëpunimit e bashkërendimit ndërmjet strukturave, me institucione të tjera e me komunitetin, si dhe relacione të kryerjes së tyre;

vii) përmbledhje e vlerësimeve të punës.

b) Për nivelin operacional:

i) vlerësimet e punës;

ii) konkluzione të analizave të punës të strukturës ku punon në tre vitet e fundit;

iii) informacione të përgatitura nga punonjësi;

iv) raste të kapjeve në flagrancë të autorëve të veprave penale ose kapje të autorëve në kërkim;

v) akte procedurale në atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore.

3. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë edhe:

a) arsimimi i punonjësit, subjekt i këtij ligji;

b) ecuria disiplinore e tij;

c) ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Nuk përbëjnë objekt vlerësimi profesional aktet procedurale të procedimeve penale në proces apo ato që përbëjnë sekret hetimor.

Neni 46

Procedura për vlerësimin e aftësisë profesionale

1. Procedura e vlerësimit të aftësive profesionale kryhet në përputhje me këtë ligj, ligjin organik përkatës dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Trupa e vlerësimit vlerëson dokumentet e përgatitura nga punonjësi, sipas afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të këtij ligji.

3. Punonjësi ka të drejtë të zgjedhë e të paraqesë për vlerësim tri dokumente zyrtare të përgatitura nga ai.

4. Publiku ka të drejtë të vërë në dispozicion informacione, të cilat denoncojnë sjellje

joprofesionale dhe joetike të punonjësit, gjatë apo jashtë ushtrimit të detyrës prej tij. Të gjitha denoncimet apo raportimet e publikut shqyrtohen nga trupa e vlerësimit dhe përfshihen prej saj në raportin përfundimtar të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale.

5. Trupa e vlerësimit, në përfundim të shqyrtimit, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale.

6. Punonjësi dhe strukturat e burimeve njerëzore dhe/ose të strukturave ku bën pjesë garantojnë pajisjen e organeve të vlerësimit me dokumentet e nevojshme.

Neni 47

Raporti i vlerësimit

1. Në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupa e vlerësimit përgatit raportin e arsyetuar dhe vendos nëse punonjësi është:

a) “I aftë”, kur punonjësi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të përshkrimeve të punës, të përcaktuara për atë funksion, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe i efektiv në masë të pranueshme;

b) “Me mangësi”, kur punonjësi ka treguar cilësi të papranueshme në punë, mangësi në zbatim të përshkrimeve të punës, të përcaktuara për atë funksion, nuk ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, ka marrëdhënie jo të mira me komunitetin;

c) “I papërshtatshëm”, kur punonjësi ka treguar cilësi të papranueshme në ushtrimin e detyrës dhe paaftësi, në atë nivel sa përmirësimi nuk mund të arrihet nëpërmjet programit të trajnimit pranë Akademisë së Sigurisë.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, trupa e vlerësimit mund të urdhërojë që punonjësi t’i nënshtrohet një programi trajnimi, me kohëzgjatje dy muaj, pranë Akademisë së Sigurisë, për të plotësuar ato mangësi, brenda një viti nga dhënia e vendimit. Testi i vlerësimit hartohet sipas gradës që mban punonjësi. Gjatë kësaj periudhe punonjësi vazhdon të mbajë gradën përkatëse dhe ka të drejtën e pages që do të përfitonte.



KREU VI PROCEDURA E VLERËSIMIT

Neni 48

Rregullat e përgjithshme të realizimit të procesit të vlerësimit

1. Gjatë hetimit administrativ, organet e vlerësimit mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike apo private, si dhe të asistohen me ekspertizë nga partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Brendshme.

2. Trupat e vlerësimit verifikojnë e vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit dhe marrin në konsideratë, në dhënien e vendimit, bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e punonjësit gjatë procesit të vlerësimit.

3. Trupat e vlerësimit verifikojnë informacionet e vëna në dispozicion nga publiku, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 49

Njoftimi

1. Njoftimet dhe çdo komunikim gjatë procesit të vlerësimit bëhen në adresën elektronike zyrtare të punonjësit ose në institucionin ku ushtron apo ka ushtruar funksionin dhe, në raste të veçanta, në adresën private elektronike apo në vendbanimin e tij.

2. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve më sipër, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 50

Të drejtat e subjektit të vlerësimit

1. Punonjësi ka të drejtën e një procesi të rregullt ligjor. Ai ka të drejtë të informohet në kohë për raportet e vlerësimit që do të diskutohen, të përgatisë mbrojtjen dhe shpjegimet përkatëse, si dhe të japë informacione të reja, nëse e gjykon të nevojshme.

2. Për sa nuk parashikohet shprehimisht në këtë ligj, të drejtat e punonjësit gjatë procesit të vlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 51

Mjetet për kërkimin e të dhënave apo informacioneve

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, trupa e vlerësimit ka të drejtë:

a) të marrë dokumente vlerësimi, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3, të nenit 3, të këtij ligji;

b) të mbledhë deklaratat nga punonjësi, nga eprorët, kolegët dhe publiku;

c) të marrë dokumente të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj ose dokumente të marra nëpërmjet mjeteve fotografike të regjistrimit apo mjeteve të tjera teknike;

ç) të kryejë verifikime në terren të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të deklaruara nga punonjësi.

2. Faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

3. Trupat e vlerësimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet e marra nga burime të njohura dhe në të dhëna të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me të dhënat e tjera. Ato vlerësojnë çdo indicie lidhur me rrethanat e çështjes, në përputhje me këtë ligj.

4. Kërkesa e punonjësit për marrjen e një të dhëne apo informacioni refuzohet nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur:

a) marrja e një të dhëne duket se është e panevojshme;

b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimarrjen;

c) mjeti i kërkuar për marrjen e një të dhëne apo informacioni është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm;

ç) bëhet me qëllim, për zvarritjen e vlerësimit;

d) pretendohet të provohet një fakt në favor të punonjësit, i cili, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.

Neni 52

Aksesi në informacion

1. Anëtarët dhe trupat e vlerësimit kanë akses të plotë në të gjitha të dhënat:

a) për gjendjen gjyqësore të punonjësit;

b) në dosjet personale të punonjësit, të dhënat statistikore, dokumentet, vetëvlerësimet, mendimet



e eprorëve, të dhënat për trajnimet, për ankesat ndaj personave që i nënshtrohen vlerësimit dhe rezultatet e verifikimit të ankesave, si dhe për vendimet për masat disiplinore ndaj të vlerësuarve;

c) për pasuritë e paluajtshme të punonjësit, të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme ose të përfituara nga një akt noterial i paregjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për këtë qëllim, trupat e vlerësimit kanë të drejtë të kërkojnë informacion nga regjistri i pasurive të paluajtshme ose nga regjistri noterial shqiptar;

ç) në llogaritë bankare, të dhënat tatimore, bazat e të dhënave për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi;

d) për të drejta ose interesa pasurorë të çdo lloji mbi një send, qoftë ky i luajtshëm ose i paluajtshëm, i trupëzuar ose i patrupëzuar, material ose jomaterial, përfshirë dhe ato të evidentuara në formë elektronike ose numerike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, instrumente të tilla si çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur ose vlerë tjetër që buron prej tyre;

dh) për marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtari tregtare ose veprimtari të tjera profesionale;

e) që provojnë ekzistencën e parave fizike, mjeteve ose instrumenteve të tjera të tregut të parasë dhe/ose të pagesave, ku përfshihen, por pa u kufizuar në, çeqet, dëftesat, certifikatat e depozitave, kartat e debitit ose të kreditit, kartat elektronike të pagesave, titujt, si dhe çdo dokument tjetër që vërteton ekzistencën e një detyrimi monetar ose një vlere tjetër të depozituar;

ë) që provojnë ekzistencën e trusteve ose të marrëveshjeve të tjera të ngjashme.

2. Nëse të dhënat dhe informacioni për çështjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, ruhen dhe administrohen në formë elektronike ose nëse përpunimi e përditësimi i tyre kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, institucioni publik ose personi juridik privat, që ushtron funksion publik, kanë detyrimin të mundësojnë aksesimin e plotë të informacionit të nevojshëm për verifikim. Niveli i aksesimit, për secilin rast, bëhet nëpërmjet niveleve të sigurisë, të përcaktuara në varësi të funksionit dhe nevojës për informacion të komisioneve.

3. Me kërkesë të trupës së vlerësimit, bankat tregtare dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë aktivitetet

bankare e financiare në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara të japin informacion për depozitat, llogaritë, kreditë, titujt e borxhit dhe transaksionet e kryera nga punonjësi ose personat e lidhur me të.

4. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave, sipas këtij neni, u nënshtrohen rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Organet e vlerësimit marrin masa organizative e teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në format elektronik, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Brenda 15 ditëve, nga marrja e kërkesës, çdo organ shtetëror dhe ent publik detyrohet të bashkëpunojë me organet përkatëse të vlerësimit për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të vlerësimit referohen në prokurori si veprë penale, sipas nenit 248, të Kodit Penal, ose përbëjnë shkelje disiplinore, sipas rastit.

6. Trupat e vlerësimit kanë të drejtë të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar, nëpërmjet oficerëve të kontaktit të vendeve partnere, brenda kuadrit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

7. Anëtarët e organeve të vlerësimit, të cilët vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë, duke mos e keqpërdorur këtë informacion, si gjatë, ashtu edhe pas përfundimit të funksioneve, duke nënshkruar edhe deklaratën përkatëse të konfidencialitetit, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 53

Përfundimet e bazuara në fakte

Organet e vlerësimit vendosin duke u bazuar në provat, të dhënat dhe informacionet që disponojnë, dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi. Në rast kur marrja e informacioneve apo të dhënave shtesë çmohet si e domosdoshme për marrjen e një



vendimi, trupa e vlerësimit mund të pezullojë procedurën deri në marrjen e këtyre provave, të dhënave apo informacioneve.

Neni 54

Bashkëpunimi me institucionet publike dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese

1. Organet e vlerësimit bashkëpunojnë me institucionet publike, personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga punonjësi.

2. Për kategorinë e punonjësve që vlerësohen nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, mbledhja, përpunimi dhe dorëzimi i informacionit kryhet nga secili institucion publik apo agjenci ligjzbatuese që e disponon apo mund ta mbledhë këtë informacion.

3. Për kategorinë e punonjësve që vlerësohen nga Komisioni Qendror dhe Vendor i Vlerësimit, mbledhja e të dhënave dhe informacioneve nga institucionet publike apo agjencitë ligjzbatuese që i disponojnë, bëhet edhe nga anëtarët e sekretariatit teknik të këtyre komisioneve, të cilët mund të trajnohen nga këto institucione.

4. Mënyrat e trajnimit, numri i anëtarëve dhe niveli i aksesit, mbledhjes e përpunimit të informacionit përcaktohen me marrëveshje ndërmjet komisioneve të vlerësimit dhe institucioneve publike apo agjencive ligjzbatuese përkatëse.

Neni 55

Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve

1. Çdo person, që vihet në dijeni të fakteve ose rrethanave për punonjës, të cilat mund të përbëjnë prova në lidhje me procesin e vlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt organet e vlerësimit.

2. Organi i vlerësimit është i detyruar të verifikojë informacionin e dhënë nga një person i njohur ose anonim. Informacioni anonim merret në konsideratë kur përmbajtja lejon verifikimin e tij dhe përmban elemente të rëndësishme për procesin e vlerësimit.

3. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kritereve të vlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet, që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat për identitetin e personit.

Faqe | 2396

4. Komisionet publikojnë një model dhënieje informacioni, me qëllimin për të lehtësuar paraqitjen e informacionit nga publiku.

5. Të drejtat dhe interesat e personave që japin informacion mbrohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 56

Seanca dëgjimore

1. Trupa e vlerësimit fton punonjës në seancë dëgjimore, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Për seancën dëgjimore mbahet procesverbal, nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv. Nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet këtyre regjistrimeve, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim.

3. Punonjësi ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi/përfaqësuesi të zgjedhur.

4. Seanca dëgjimore është publike dhe zhvillohet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, me përjashtim të zhvillimit të seancave dëgjimore nga trupat e posaçme të vlerësimit apo të rasteve të lidhura me të dhëna sensitive për punonjës apo personave të lidhur me të. Në këto raste, trupa e vlerësimit vendos zhvillimin e seancës dëgjimore me dyer të mbyllura.

5. Trupa e vlerësimit ka të drejtë të marrë në pyetje punonjës, i cili ka të drejtë të mos u përgjigjet pyetjeve. Pyetjet mund të përfshijnë njohuritë dhe aftësitë praktike në fushën e veprimtarisë së punës, ku punonjësi ka ushtruar detyrën vitin e fundit, si dhe plotësime të deklarimeve të bëra më parë nga vetë punonjësi.

6. Punonjësi ka të drejtë të dëgjohet dhe të japë shpjegimet e veta në lidhje me raportin e trupës së vlerësimit apo faktet e diskutuara në seancë. Në këto raste, trupa e vlerësimit ka të drejtë të kufizojë, në mënyrë të arsyeshme, kohën e parashikuar për t'u shprehur nga ana e punonjës.

7. Diskutimet për marrjen e vendimit të vlerësimit zhvillohen me dyer të mbyllura. Vendimi merret me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve. Nëse gjatë vendimmarrjes ka qëndrime të ndryshme nga ai i shumicës, anëtari i trupës së vlerësimit i mbetur në pakicë ka detyrimin të shpjegojë me shkrim mendimin e tij. Gjatë diskutimit mbahet procesverbal nga një anëtar i sekretariatit teknik.



8. Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore dhe i njoftohet edhe me shkrim punonjësit, brenda 15 ditëve pas përfundimit të kësaj seance. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit përkatës.

Neni 57 Dorëheqja

1. Punonjësi ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet, me shkrim, titullarit të institucionit përkatës.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, punonjësi ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas parashikimeve të ligjit “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 58 Elementet e vendimit të vlerësimit

1. Relatori i trupës së vlerësimit arsyeton me shkrim vendimin e trupës së vlerësimit.

2. Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese.

3. Hyrja e vendimit përmban:

- a) emërtimin zyrtar të komisionit;
- b) trupën e vlerësimit, që ka shqyrtuar çështjen, dhe anëtarët e sekretariatit teknik, që kanë asistuar;
- c) orën, datën dhe vendin e vendimit të dhënë;
- ç) emrin dhe identitetin e punonjësit, si dhe të përfaqësuesit të tij, nëse ka;
- d) mendimin dhe pretendimet e punonjësit dhe/ose të përfaqësuesit të tij.

4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban:

- a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra;
- b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi;
- c) përfundimet e raportit dhe rekomandimin e relatorit të trupës së vlerësimit;
- ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.

5. Pjesa urdhëruese, ndër të tjera, përmban:

- a) dispozitivin;

b) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.

6. Vendimi nënshkruhet nga të tre anëtarët e trupës së vlerësimit.

Neni 59

Vendimi përfundimtar i trupës së vlerësimit

Në përfundim të procesit të vlerësimit të punonjësit, trupa e vlerësimit vendos:

- a) konfirmimin në detyrë;
- b) detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Akademia e Sigurisë;
- c) detyrimin e titullarit të institucionit për emërimin në detyrë të ish-punonjësve;
- ç) përjashtimin nga detyra.

Neni 60

Konfirmimi në detyrë

1. Konfirmimi në detyrë i jepet punonjësit në rast se plotësohen, së bashku, këto kushte:

- a) konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) konstatohet nivel i besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

2. Në rastet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, trupa e vlerësimit arsyeton në vendim se punonjësi konfirmohet për të vazhduar ushtrimin e detyrës.

Neni 61

Detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit

1. Detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit dymujor, brenda një periudhe 1-vjeçare, nga momenti i dhënies së vendimit, jepet nëse janë evidentuar mangësi në aftësitë profesionale të punonjësit, të cilat mund të përmirësohen.

2. Në rast se punonjësi përfundon programin e trajnimit, Akademia e Sigurisë i paraqet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të institucionit ku është i punësuar punonjësi rezultatet e provimit përfundimtar, duke u shprehur nëse përfundon me sukses ose jo.



Neni 62

Përfshirja nga detyra

Trupa e vlerësimit vendos përfshirjen nga detyra të punonjësit kur:

a) punonjësi nuk dorëzon deklaratat sipas objekteve të vlerësimit kalimtar dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj;

b) deklaratat përmbajnë të dhëna të rreme;

c) rezulton se, gjatë vlerësimit të pasurisë, ka fshehur pasuri, përfshirë edhe personat e lidhur me të;

ç) pasuria e deklaruar nuk mund të justifikohet nga burime të ligjshme të ardhurash;

d) rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, që bën të pamundur vazhdimin e detyrës;

dh) rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.

Neni 63

E drejta e ankimit

Kundër vendimeve të organeve të vlerësimit mund të ushtrohet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 64

Trajnimi paraprak i anëtarëve të komisioneve të vlerësimit

1. Anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sekretariateve teknike pranë tyre, përpara fillimit të detyrës, i nënshtrohen një procesi trajnimi që kryhet në bashkëpunim me institucionet e parashikuara në këtë ligj dhe misionet ndërkombëtare, që asistojnë Ministrinë e Brendshme.

2. Anëtari i komisionit të vlerësimit dhe sekretariatit teknik, i nënshtrohen trajnimit vetëm një herë, pavarësisht pjesëmarrjes në më shumë se një komision vlerësimi.

Neni 65

Vlerësimi periodik i punonjësve

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve, sipas këtij ligji, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat do t'i nënshtrohen

Faqe | 2398

vlerësimit periodik çdo 3 vjet, bazuar në analizën e riskut për struktura apo njësi të caktuara, si dhe në informacione apo të dhëna të ndryshme.

2. Objekti, parimet dhe procedura e vlerësimit periodik të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale është e njëjtë me atë të vlerësimit kalimtar, përcaktuar në këtë ligj.

3. Shtojcat e këtij ligji përdoren si formularë të detyrueshëm për t'u plotësuar për vlerësimin periodik të punonjësve dhe për të gjithë punonjësit që emërohen në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

4. Në deklaratat që plotësohen gjatë vlerësimit periodik, punonjësit deklarojnë vetëm ndryshimet që kanë ndodhur gjatë periudhës nga vlerësimi kalimtar apo data e emërimit në institucionin përkatës deri në datën kur përcaktohen si subjekte të vlerësimit periodik.

5. Punonjësit që parashikohen në pikën 1, të nenit 6, plotësojnë formularët, shtojcë e këtij ligji, çdo vit. Formularët dorëzohen në njësinë e burimeve njerëzore të institucioneve përkatëse, e cila i mban në ruajtje dhe i përcjell pranë Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave për vlerësim periodik.

6. Institucioni që bën verifikimin e të dhënave të deklaruara nga punonjësit, sipas formularëve përkatës, është Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Për këtë qëllim, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

7. Në përfundim të procesit të verifikimit të të dhënave, sipas pikës 6, të këtij neni, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat përgatit dhe u paraqet titullarëve të institucioneve përkatëse raportin sipas objektit të vlerësimit.

8. Rregullat për kryerjen e analizës së riskut, organizimi i shortit për punonjësit që do t'i nënshtrohen verifikimit dhe procedura e kryerjes së verifikimit nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 66

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë



aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 29, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Brendshëm që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të pikës 8, të nenit 65, të këtij ligji.

Neni 67

Nënkomisioni

Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurinë Kombëtare në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë krijohet një nënkomision, i cili organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet.

Neni 68

Dispozitë kalimtare

Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat do të përfundojë brenda një periudhe prej 24 muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 69

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10747, datë 20.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Adresa:

SHTOJCA 1

Nr. Indeksi dhe Viti	

DEKLARATË E PASURISË

Plotësohet nga subjekti i vlerësimit që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë së tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë dhe çdo personi të përmendur në certifikatën familjare, në bazë të ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”;

AUTORIZIM
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË

Emri	Atësia	Mbiemri
Funksioni		
Institucioni dhe adresa		
